

N J O F T I M:

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.88 datë 29.07.2025, i cili ka miratuar fillimin e procedurave të shpronësimit për pasuritë që preken nga realizimi i projektit me interes publik, ***“Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Bajram Curri”, nga intersektimi me rrugën “Vasil Llapushi” deri në intersektimin me rrugën “Iliaz Kosova” ndodhur në Z.K 8523”***, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”, si dhe mbështetur në ligjin nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, i ndryshuar, kërkohet që brenda datës 25.08.2025, pronari/ët e pasurive ose të tretë të cilëve i’u preket pasuria, të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Pronave Publike dhe Strehimit, fotokopje të noterizuar të dokumenteve të pronësisë lëshuar nga ASHK Elbasan si dhe fotokopje karte identiteti.